*"NDERTIM FUSHA SPORTIVE + PARKING SI DHE RRUGE, VALIAS"*

***BASHKIA KAMËZ***

BASHKIA KAMËZ

MIRATOI

**RAKIP SULI**

KRYETAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KAMËZ

# RAPORT ARKITEKTONIK

*(FAZA PROJEKT-ZBATIM)*

## "NDERTIM FUSHA SPORTIVE + PARKING SI DHE RRUGE, VALIAS"


**PROJEKTUES : BASHKIA KAMEZ**

**Ark.** Adelina OMURI

**Ing.** Artur ÇAJKA

**Ing.** Aleks DANI

**Ark.** Estela GJYRIQI

**Ark.** Brisilda Cani

**DR. E P.I-SE:**

**Ing.** Ramadan HYSA

PERMBAJTJA

1. HYRJE ........ 3
2. VENDODHJA ........ 4
3. TE DHENAT PER OBJEKTIN ........ 4
4. GJENDJA EKZISTUESE ........ 5
5. ZHVILLIMI I PROJEKTIT ........ 6
6. PLANI I VENDOSJES SE OBJEKTIT ........ 13
7. PLAN SISTEMIMI ........ 14
8. PLANIMETRIA E SINJALISTIKES ........ 15
9. DETAJE ........ 16
10. RENDERA ........ 18

## 1. HYRJE

Bashkia Kamëz ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, në veriperëndim të saj. Kufizohet nga veriu me Krujën, nga jugu me Tiranën, nga lindja me Zall-Herrin dhe nga perëndimi me Bërxullin. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit.

Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbret në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit.

Kamëza ndodhet në trekëndëshin strategjik: kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit.

Bashkia Kamëz pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan.



## 2. VENDODHJA E OBJEKTIT

Trualli per ndertimin e objektit **"NDERTIM FUSHA SPORTIVE + PARKING SI DHE RRUGE, VALIAS"** ndodhet ne brendesi te zones se Valiasit, ne Lagjen Administrative nr.1 ne territorin e Bashkise Kamez.



*Figura 1 Vendodhja*

## 3. TE DHENAT PER OBJEKTIN

Siperfaqja e gjurmes ku do te behet ndertimi i fushes sportive se bashku me parkimin dhe rrugen eshte 10554.9 m2 prej te cilave:

Fusha Sportive ka nje siperfaqe prej 3168 m2

Parkim me siperfaqe 2260 m2

Hapesire Rekreacioni 1839.3 m2 siperfaqe e shfrytezueshme per gjelberim.

Seg pingul rr. Mati 1526 m2.

## 4. GJENDJA EKZISTUESE

Fusha sportive, parkingu se bashku me rrugen do te ndertohen ne fshatin Valias. Sheshi ne te cilen do te ndertohen paraqitet teper kaotik. Nuk kemi nje rregull urban te zbatuar pasi eshte nje zone e painvestuar me pare. Sistemi rrugor pershkon sheshin ne te gjithe perimetrin e tij dhe paraqiten si rruge dytesore te cilat jane ne gjendje te keqe, te pashtruara te cilat jane te paaksesueshme nga makinat ne ditet e sotme per shkak te gjendjes se tyre. Ne shesh kemi nje gjelberim rastesor qe shtrihet ne te gjithe siperfaqen e sheshit.

**Foto te gjendjes ekzistuese**







## 5. ZHVILLIMI I KONCEPT-IDESË

Ky objekt parashikon ndërtimin e një fushe sportive moderne, të projektuar për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative për komunitetin. Fusha sportive do të realizohet sipas standardeve bashkëkohore, me shtresë cilësore sportive, sistem kullimi, ndriçim dhe rrethim sigurie, duke garantuar funksionalitet dhe përdorim afatgjatë.

Në kuadër të projektit do të ndërtohet edhe një hapësirë parkimi për automjete, e organizuar për të përballuar nevojat e përdoruesve dhe vizitorëve të objektit. Parkingu do të pajiset me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, ndriçim dhe sistem kullimi të ujërave atmosferike.

Gjithashtu, projekti përfshin ndërtimin dhe sistemimin e rrugës hyrëse dhe lidhëse me infrastrukturën

ekzistuese. Rruga do të realizohet me shtresa asfaltike, trotuare anësore sipas nevojës, si dhe elementë të sigurisë rrugore për qarkullim të sigurt të automjeteve dhe këmbësorëve.

Ky investim synon përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe urbane, krijimin e kushteve më të mira për aktivitet fizik dhe rritjen e aksesueshmërisë në zonë.

## Ndertimi i Fushes Sportive

Objekti konsiston në ndërtimin e një fushe sportive me dimensione **67.3 x 49.2 m**, së bashku me sistemimin e hapësirave të parkimit dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore lidhëse, të projektuara sipas standardeve teknike dhe funksionale bashkëkohore.

Fusha sportive do të realizohet me sipërfaqe me **bar sintetik me trashësi 55–60 mm (5cm)**, i përshtatshëm për përdorim intensiv sportiv dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike. Nën shtresën e barit sintetik do të vendoset shtresë rere me trashësi **10 cm**, e cila shërben për nivelim dhe stabilizim të sipërfaqes sportive.

Për garantimin e drenazhimit efikas të ujërave atmosferike, projekti parashikon shtresë drenazhuese me çakëll me trashësi **30 cm**, të pajisur me tuba drenazhimi Ø110 mm, të vendosur sipas pjerrësive teknike për largimin e ujërave.

Struktura mbajtëse e fushës do të realizohet me shtresë betoni **C-15/20** me trashësi **10 cm**, e armuar me zgare hekuri Ø8, ndërsa në bazë do të realizohet mbushje me çakëll shkëmbor me trashësi **10 cm**, e cila garanton stabilitetin dhe kapacitetin mbajtës të terrenit.

Perimetri i fushës do të rrethohet me rrethim sigurie me lartësi **8 m**, i realizuar me konstruksion metalik dhe rrjetë mbrojtëse për sigurinë e përdoruesve dhe kontrollin e ambienteve sportive.

## PLANIMETRIA E FUSHËS SË SPORTIT






PLANIMETRIA E FUSHËS SË SPORTIT DHE HAPËSIRA REKREATIVE




## Ndertimi i Parkimit

Në kuadër të projektit do të realizohet edhe një hapësirë parkimi me gjithsej **42 poste parkimi**, të organizuara sipas funksioneve dhe kategorive përkatëse, konkretisht:

- **35 poste parkimi për automjete**, me dimensione **2.7 x 5.0 m** secili;
- **3 poste parkimi për persona me aftësi ndryshe**, të projektuara sipas standardeve të aksesueshmërisë;
- **2 poste parkimi për autobusë**, me dimensione **14 x 4 m**;
- **1 post parkimi për ambulancë**, me dimensione **10.7 x 4.5 m**;
- **1 post parkimi për automjet zjarrfikës**, me dimensione **11.6 x 4 m**.

Parkimi do të pajiset me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, sistem kullimi të ujërave atmosferike dhe ndriçim të jashtëm, duke garantuar funksionalitet dhe qarkullim të sigurt për automjetet dhe këmbësorët.

**PLANIMETRIA E PARKINGUT**






PROFIL TERTHOR TIP
NDERTIM PARKING (FUSHAT SPORTIVE)
SHKALLA 1:50



## Ndertimi i Rruges

Projekti përfshin gjithashtu ndërtimin e rrugës lidhëse dhe hyrëse në objekt, e cila do të realizohet me gjerësi **7 m asfalt**, e shoqëruar me **0.5 m kub** dhe **1.5 m trotuar në njërën anë** të rrugës, duke siguruar akses të sigurt për automjetet dhe lëvizjen e këmbësorëve. Rruga do të pajiset me sistem kullimi, sinjalistikë dhe elementë të sigurisë rrugore sipas standardeve teknike në fuqi.

Ky projekt synon krijimin e një infrastrukture sportive dhe urbane moderne, funksionale dhe të aksesueshme, në shërbim të komunitetit dhe aktiviteteve sportive.

**PLANIMETRIA E RRUGES**



## 6. PLANI I VENDOSJES SE OBJEKTIT

**PLANVENDOSJES**



## 7. PLANSISTEMIMI



## 8. PLANIMETRIA E SINJALISTIKES



## 9. DETAJE

PROFIL TERTHOR TIP
FUSHA SPORTIVE
SHKALLA 1:50



PROFIL TERTHOR TIP
NDERTIM RRUGA (FUSHAT SPORTIVE)
SHKALLA 1:50






## Trotuar + gjelberim



**10. RENDERA**



